



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060-20481 dt. 16.06 2020

**Mbledhja e Jashtëzakonshme
Kuvendi Komunal
10.06.2020**

PROCESVERBALI

I mbledhjes se jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë:
10.06.2020

Mbledhjen e kryesoi: LABINOT HALILAJ – Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 22 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Propozim Vendim për Rishikim të buxhetit për vitin 2020.
2. Kërkesë për aprovimin e kandidatëve për komision në përzgjedhjen e drejtorëve/zv drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore në Drenas.

Prezent gjatë mbledhjes së rregullt të datës 10 /06/ 2020, ishin: Nënkryetari i Komunës Nazmi Hasi, shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, kryesuesi Kuvendit Komunal, Labinot Halilaj, dhe drejtorët e Drejtorive përkatëse.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj; para se të fillojmë me seancën ju kisha lutur që me rastin e vdekjes së nënës së Heroit Fehmi Lladrovci në shenjë respekti ta mbajmë një minutë heshtje nderim. Lavdi!

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj: deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Kuvendit pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi pikat e rendit të ditës, a ka dikush diçka, nuk kalojmë të pika e parë e rendit të ditës; **1. Propozim Vendim për Rishikim të buxhetit për vitin 2020.**

Fjalën ja kaloi drejtorit të Drejtorisë së Financave: **Shyqyri Bublaku** i cili paraqiti arsyetimin e Propozim Vendimit për rishikim të Buxhetit për vitin 2020.

Shyqyri Bublaku- Transferi dhe ridestinimi i projekteve kapitale ishte i detyrueshem për shkak të pandemisë globale COVID-19 e cila u reflektua edhe në Republikën e Kosovës dhe ndikimi i saj përveq ne shëndetin publik ishte edhe në ekonomi dhe në realizimin e fillimit të realizimit të projekteve të reja për shkak të zvoglimit të hyrave vetanake komunale dhe pamundësisë së shpalljes së procedurave të reja tenderuese.

Kemi bërë rregullimet e arsyeshme buxhetore përmes transfereve dhe ridestinimeve të kategorive ekonomik të shpenzimeve kapitale me qëllim të përballimit më të lehtë të situatës së pandemisë COVID-19 dhe ekzekutimin efikas të buxhetit Komunal për periudhën e mbetur të vitit 2020.

Rishikimi i kërkuar do të mundësoj plotësimin e kushteve për përfundimin e projekteve të kërkuar përmes transfereve dhe ridestinimeve.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj Faleminderit drejtor diskutime s'ka, e kalojmë në votim, pra miratohet në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj Kalojmë tek pika e dytë; **2. Kërkesa për aprovimin e kandidatëve për komision në përzgjedhjen e drejtorëve/zv drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore në Drenas.**

Fjalën ja kalojmë drejtorit të Drejtorisë së Arsimit **Muhamet Xhoka** i cili prezantoi arsyetimin e kërkesës para asamblistëve; Te nderuar Asamblistë Komunal, Kryesues, drejtor të drejtorive Drejtoria për Arsim në Drenas kërkon aprovimin nga ju për dy kandidatë të Komisionit përzgjedhës për drejtor/zv. drejtor në Institucionet edukativo-arsimore në Drenas, si:

1. Drejtor në Gjimnazin "GJ.K. Skënderbeu"- Drenas.
2. Drejtor në SHFMU "Rasim Kiqina"- Drenas,
3. Drejtor në SHFMU "Mehdi dhe Sylejman Bytyqi" – Arllat,
4. Drejtor në SHFMU "Shotë Galica"- Abri e Epërme,
5. Drejtor në SHFMU "Fazli Grejgevc"- Vasilevë,
6. Zv. Drejtor në Gjimnazin "GJ.K. Skënderbeu"- Drenas,
7. Drejtor në SHFMU "Xhevë Lladrovci"- Gllanasellë, dhe
8. Drejtor në SHFMU "Dëshmoret e Qëndresës II"- Tërstenikë.

Kandidatet për komision për procedurat e mundshme për drejtor, zv. drejtor të Institucioneve edukativo-arsimore, janë:

1. Dr.sc. Lulzim Nika - DKA
2. Arben Haziri – Këshilli i Prindërve

Me këtë kërkesë konfirmoj se personat e shënuar më lartë përmbushin kriteret të jenë anëtarë të Komisionit, sipas nenit 5, pikat 1.2 dhe 1.3 të Udhëzimit administrativ (MASHT) Nr. 15/2019 për detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës drejtorit të Institucionit publik edukativo – arsimor dhe aftësues para universitar. Po ashtu, për shkak të vëllimit të madh të kandidatëve për vende punë që duhet plotësuar, lusim nga ju që t'i aprovoni këta anëtarë të Komisionit për të gjitha konkurset që shpallen gjatë vitit 2020.

Kryesuesi i Kuvendit z. Labinot Halilaj Faleminderit drejtor diskutime s'ka, e kalojmë në votim, pra miratohet në mënyrë unanime.

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 10: 22 min.

Procesmbajtëse:


Zahrie Podrimqaku Subashi

